



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

PËRMBLEDHJE E AKTGJYKIMIT

(Vetëm për mediat. Nuk është dokument zyrtar)

D H O M A E
A P E L I T

Hagë, 21 korrik 2010

Përmbledhje e Aktgjykimit në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*

Më poshtë vijon përmbledhja e aktgjykimit shqiptuar sot prej gjykatësit Patrick Robinson:

Dhoma e Apelit e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë është mbledhur sot në seancë publike për të shqiptuar vendimin e saj në çështjen *Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*. i cili u mor më 19 korrik 2010.

Duke u mbështetur në praktikën e Tribunalit, unë do të jap një përmbledhje të përfundimeve të Dhomës së Apelit. Përmbledhja nuk është pjesë e Aktgjykimit i cili është i vetmi version autoritativ i përfundimeve dhe arsyetimit të Dhomës së Apelit. Palëve do t'u vihen në dispozicion kopje të Aktgjykimit sa më shpejt pas përfundimit të seancës.

Në Aktgjykim, toponimet në Kosovë të cilat janë të ndryshme në shqip dhe në gjuhën bosnjake/kroate/serbe janë dhënë në të dyja gjuhët ndarë prej një vije të pjerrët. Për hir të lehtësisë së leximit të përmbledhjes [në anglisht] unë do të përdor vetëm versionin në gjuhën bosnjake/kroate/serbe.

Ramush Haradinaj u lind më 3 korrik 1968 në komunën e Deçanit në Kosovë, në ish-Jugosllavi. Në Aktakuzë pretendohet se afërsisht prej 1 marsit 1998 deri në mes të qershorit 1998, ai ishte komandant *de facto* në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ose UÇK, dhe se në mes të qershorit u emërua komandant duke pasur komandën e përgjithshme të forcave të UÇK-së në Dukagjin.

Idriz Balaj u lind më 23 gusht 1971 në komunën e Klinës në Kosovë. Në Aktakuzë pretendohet se ai ishte anëtar i UÇK-së dhe komandonte një njësi të posaçme që quhej Shqiponjat e Zeza.

Lahi Brahimaj u lind më 26 janar 1970 në komunën e Gjakovës në Kosovë. Në Aktakuzë pretendohet se ai ishte anëtar i UÇK-së dhe shërbeu si zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të zonës së Dukagjinit gjatë periudhës 23 qershor - 5 korrik 1998, dhe më tej si Drejtor i Financës në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.

Ngjarjet të cilat trajtohen në këtë çështje ndodhën gjatë periudhës 1 mars - 30 shtator 1998 në Kosovë. Në Aktakuzë pretendohet se UÇK-ja përdoqi dhe rrëmbeu civilë për të cilët mendohej se bashkëpunonin me forcat serbe në zonën e Dukagjinit. Prokuroria i akuzoi Ramush Haradinajn, Idriz Balajn, dhe Lahi Brahimajn si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale në lidhje me kryerjen e krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljeve të ligjeve ose zakoneve të luftës. Qëllimi i përbashkët kriminal i ndërmarrjes së përbashkët kriminale sipas Aktakuzës ishte konsolidimi i kontrollit tërësor të UÇK-së mbi zonën e Dukagjinit me anë të largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të këtyre civilëve. Ndryshe Prokuroria i ngarkoi të akuzuarit me përgjegjësi individuale penale për forma të tjera përgjegjësie bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit.

<http://www.icty.org>

Media Office/Communications Service

Churchillplein 1, 2517 JW The Hague. P.O. Box 13888, 2501 EW The Hague. Netherlands

Tel.: +31-70-512-8752; 512-5343; 512-5356 Fax: +31-70-512-5355

Në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, Dhoma Gjyqësore gjykoi se provat në dispozicion të saj nuk ishin të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe i liroi të tre të Akuzuarit prej përgjegjësisë penale për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore i shpalli të pafajshëm Z. Haradinaj dhe Z. Balaj për të gjitha akuzat alternative në Aktakuzë. Gjithsesi Dhoma Gjyqësore e shpalli Z. Brahimaj fajtor në lidhje me një pikë për torturim dhe në lidhje me një pikë tjetër, për torturim dhe trajtim mizor, të gjitha këto si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Për të gjitha pikat e tjera Z. Brahimaj nuk u shpall fajtor. Dhoma Gjyqësore e dënoi Z. Brahimaj me një dënim të vetëm prej gjashtë vjetësh burgim.

Si Prokuroria po ashtu edhe Z. Brahimaj e apeluan Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore. Seanca mbi apelimet u zhvillua më 28 tetor 2009.

Fillimisht unë do të trajtoj apelin e Prokurorisë. Në pikën e parë të apelit të saj Prokuroria argumentoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur refuzoi kërkesat e Prokurorisë për kohë shtesë për shfrytëzimin e të gjitha hapave të arsyeshme për të mundësuar dhënie dëshmie prej dy dëshmitarëve kyç dhe urdhëroi mbylljen e procedimit të çështjes së Prokurorisë para marrjes së këtyre masave të arsyeshme. Prokuroria pretendoi se këta dëshmitarë zotëronin prova të drejtpërdrejta në lidhje me fajësinë e të tre të akuzuarve, dhe këta dëshmitarë refuzuan të dëshmonin për shkak të kërcënimeve dhe frikës. Rrjedhimisht në parashtrimin e vet Prokuroria kërkoi rigjykim në lidhje me disa pika.

Shumica e Dhomës së Apelit me përjashtim të gjykatësit Robinson e miratoi këtë pikë të apelit dhe urdhëroi rigjykim të pjesshëm. Çdo vendim i Dhomës Gjyqësore në lidhje me dhënie dëshmie prej dëshmitarëve përkatës mund të konsiderohet se përfshihet në kompetencën gjyqësore të Dhomës Gjyqësore. Mirëpo duke i shqyrtuar këto vendime së bashku, dhe konkretisht në kuadrin e frikësimit të rëndë të dëshmitarëve që karakterizoi procesin gjyqësor, del qartë se Dhoma Gjyqësore gaboi rëndë kur nuk mori masat e mjaftueshme për të mundësuar dhënien e dëshmisë prej disa dëshmitarëve. Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësi të tepruar faktit që Prokuroria nuk mund të përdorte më shumë se koha që i ishte caktuar për paraqitjen e çështjes dhe që të respektoheshin afatet e Dhomës Gjyqësore për paraqitjen e provave, me gjithë mundësinë e sigurimit të dëshmive me gjasë të rëndësishme. Përcaktimi i gabuar i përparësive tregon se Dhoma Gjyqësore nuk vlerësoi rrezikun që sillte frikësimi i dëshmitarëve ndaj ndershmërisë së procesit gjyqësor. Disa prej këtyre gabimeve u bënë në përgjigjet ndaj kërkesave konkrete të Prokurorisë, kurse në disa raste të tjera Dhoma Gjyqësore duhej të kishte vepruar me nismën e vetë për të mundësuar dhënien e dëshmive prej dëshmitarëve. Për arsyet e parashtruara në Aktgjykim, rrjedhimisht Dhoma e Apelit ka konkluduar se Dhoma Gjyqësore nuk mori masat e mjaftueshme si kundërpërgjigje ndaj frikësimit të dëshmitarëve që karakterizoi procesin gjyqësor. Duke marrë parasysh rëndësinë e mundshme të këtyre dëshmitarëve për argumentet e Prokurorisë, gabimi çënoi ndershmërinë e procesit dhe rezultoi në dështim të drejtësisë.

Aktgjykimit i kam bashkëngjitur arsyetimin tim të veçantë, ku shpreh mospajtimin tim me shumicën e kolegëve të mi në lidhje me pikën e parë të apelit të Prokurorisë.

Në pikën e dytë të apelit të saj, Prokuroria kundërshtoi dhënien e pafajësisë Idriz Balajt prej Dhomës Gjyqësore në lidhje me ndihmë dhe inkurajim në vrasjen e tri grave duke argumentuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se nuk ishin plotësuar kushtet e synimit kriminal dhe veprimit të fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit. Dhoma e Apelit nuk ka konstatuar gabim në zbatimin e standardeve ligjore për ndihmë dhe inkurajim nga ana e Dhomës Gjyqësore dhe rrjedhimisht e hedh poshtë këtë pikë.

Në pikën e tretë të apelit, Prokuroria kundërshton konkluzionet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me përdhunimin, torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitares 61 dhe trajtimin mizor të Dëshmitarit 1. Fillimisht Prokuroria parashtrroi se Dhoma Gjyqësore kishte gabuar kur gjykoi se Idriz Balaj nuk ishte fajtor për përdhunimin, trajtimin mizor dhe torturimin e Dëshmitares 61, duke argumentuar se ishte qartësisht jologjike që Dhoma Gjyqësore ta

nxirrte Z. Balaj të pafajshëm pasi kishte konkluduar se ai ishte personi I njohur si Togeri. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit e rrëzoi argumentin e Prokurorisë dhe la në fuqi pafajësinë e Z. Balaj në lidhje me këtë pikë. Gjithashtu në pikën 3 të apelit Prokuroria pretendoi se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur nuk konkludoi se hedhja e Dëshmitarit 1 në një pus prej ushtarëve të UÇK-së përbënte trajtim mizor, me argumentin se ky ishte sulm i rëndë kundër dinjitetit njerëzor të Dëshmitarit 1. Pas analizimit të provave në dispozicion të Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit gjykoi se megjithëse Dëshmitari 1 nuk ishte viktimë e një veprimi ose mosveprimi të qëllimshëm me pasojë vuajtje të rëndë fizike, trajtimi i shkaktoi atij vuajtje të rëndë mendore dhe përbënte sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor të Dëshmitarit 1, i cili u neutralizua duke e hedhur në një pus dhe u veçua prej bashkëshortes së tij e cila ndodhej në duar të ushtarëve të armatosur të UÇK-së. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit miratoi pjesërisht pikën e apelit të Prokurorisë dhe rrëzoi konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se trajtimi i Dëshmitarit 1 nuk përbënte trajtim mizor. Mirëpo megjithëse Prokuroria provoi se ushtarët e UÇK-së kryen trajtim mizor kundër Dëshmitarit 1, nuk u provua se Z. Balaj ishte përgjegjës në lidhje me trajtimin mizor për format e përgjegjësisë pretenduar prej Prokurorisë. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit lë në fuqi pafajësinë e Z. Balaj në lidhje me këtë pikë.

Më tej vijojmë me nëntëmbëdhjetë pikat e apelit të Lahi Brahimajt ku ai kërkon që Dhoma e Apelit të shfuqizojë verdiktin e fajësisë së tij në lidhje me torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitarëve 6 dhe 3 dhe kundërshton dënimin e tij.

Në pikat 1 dhe 2 të apelit, Z. Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri gabime të shumta kur konkludoi se ai ishte përgjegjës për torturimin e Dëshmitarit 6. Për arsyet e parashtruara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit i hedh poshtë këto pika.

Në pikat 3-8 të apelit, Z. Brahimaj ngre kundërshtime të shumta ndaj konkluzioneve të Dhomës Gjyqësore se ai ishte përgjegjës për torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitarit 3. Për arsyet e parashtruara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit i hedh poshtë këto pika.

Në pikën 9 të apelit, Z. Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi në verdiktin e fajësisë së tij për torturimin e Dëshmitarit 3 me arsyetimin se Prokuroria nuk mundi të provojë domosdoshmërinë e ndonjë prej motiveve të keqtrajtimit të Dëshmitarit 3 për fajësinë e torturimit. Dhoma e Apelit ka konkluduar se Prokuroria nuk argumentoi fakte materiale për një prej motiveve që përbëjnë bazën e fajësimit për torturim dhe se Dhoma Gjyqësore kishte gabuar sepse Zotit Brahimaj nuk iu dha paralajmërimi i duhur për bazën e akuzës së fajësisë së torturimit. Gjithsesi për arsye se Dhoma Gjyqësore u mbështet në më shumë se një motiv për fajësinë e torturimit, lihet në fuqi fajësia e tij për torturimin e Dëshmitarit 3.

Në pikat 10-19 të apelit, Z. Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabime të shumta kur e dënoi me gjashtë vjet burgim. Për arsyet e parashtruara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit i hedh poshtë këto pika dhe lë në fuqi dënimin e Z. Brahimaj.

Tani do të lexoj vendimin e Aktgjykimit të Dhomës së Apelit.

Z. Haradinaj, Z. Balaj, dhe Z. Brahimaj ju lutem ngrihuni.

Për arsyet e lartpërmendura, **DHOMA E APELIT**,

BAZUAR NË Nenin 25 të Statutit të Tribunalit dhe Rregullat 117 dhe 118 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit;

DUKE MARRË PARASYSH parashtrimet përkatëse me shkrim të palëve dhe argumentet e paraqitura prej tyre në seancën e apelit më 28 tetor 2009;

Në lidhje me apelin e Prokurorisë,

MIRATON Pikën 1 të Apelit të Prokurorisë, me përjashtim të gjykatësit Robinson, dhe SHFUQIZON vendimin e Dhomës Gjyqësore: (a) që shpalli të pafajshëm Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të Aktakuzës; (b) që shpalli të pafajshëm Lahi Brahimajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 30, dhe 34 të Aktakuzës; (c) që liroi prej përgjegjësive penale individuale Ramush Haradinajn, Idriz Balajn, dhe Lahi Brahimajn në lidhje me Pikat 24 dhe 34 të Aktakuzës; dhe (d) që liroi prej përgjegjësive penale individuale Lahi Brahimajn në lidhje me Pikën 26 të Aktakuzës, dhe URDHËRON që Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, dhe Lahi Brahimaj të rigjykohe në lidhje me këto pika;

HEDH POSHTË Pikën 2 të Apelit të Prokurorisë;

MIRATON pjesërisht, dhe HEDH POSHTË pjesërisht, Pikën 3 të Apelit të Prokurorisë dhe LË NË FUQI pafajësinë e Idriz Balajt në lidhje me Pikën 37;

Në lidhje me apelin e Lahi Brahimajt,

HEDH POSHTË Pikat 1-8 të Apelit të Lahi Brahimajt;

MIRATON pjesërisht dhe HEDH POSHTË pjesërisht, Pikën 9 të Apelit të Lahi Brahimajt dhe LË NË FUQI fajësinë e Lahi Brahimajt në lidhje me Pikën 28;

HEDH POSHTË Pikat 10-19 të Apelit të Lahi Brahimajt;

LË NË FUQI dënimin e Lahi Brahimajt; dhe

BAZUAR NË Rregullën 64 dhe Rregullën 107 të Rregullores së Procedurës dhe Provave,

URDHËRON marrjen në paraburgim të Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, dhe Lahi Brahimajt dhe UDHËZON Komandantin e Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara në Hagë që t'i mbajë në paraburgim deri në një urdhër tjetër.

Aktgjykimit i kam bashkëngjitur arsyetimin tim pjesërisht mospajtues, ku shpreh mospajtimin tim me konkluzionet e shumicës në lidhje me pikën e parë të apelit të Prokurorisë.

Mund të uleni.

Dhoma e Apelit shfuqizon konfidencialitetin e fletarrestimit të lëshuar për Ramush Haradinajn më 19 korrik 2010.

Pas përfundimit të seancës palëve do t'u jepen kopje të Aktgjykimit.

Deklaroj të mbyllur seancën e Dhomës së Apelit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.